



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 03  
Prishtinë, më 10. 02. 2010, në orën 13:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**P R O C E S V E R B A L**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

**Mbledhjen e monitoruan:** Floriana Shala – OSBE, Burim Xhemajli – Gazeta Lajm, Naser Ajeti – ABGJ / ZKM, Shqipe Krasniqi - ABGJ / ZKM, Rrezarta Ahmeti – KDI, Elita Vokshi – OSBE.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Rrahim Demaj dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e drejtoi: Ismet Beqiri.**

**Kryetari** konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Për këtë mbledhje u propozua ky

*R e n d i d i t ë s*

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26. 01. 2010,
3. Marrja e qëndrimit rreth zgjidhjes dhe mënyrës së zbatimit të vendimeve të KPMK- së,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje,
5. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26. 01. 2010**

*Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 26. 01. 2010.*

### **3. Marrja e qëndrimit rreth zgjidhjes dhe mënyrës së zbatimit të vendimeve të KPMK - së**

**Kryetari** - I përshëndeti përfaqësuesit e EULEX – it, Agjencisë për Barazi Gjinore, Koalicionin e strehimoreve për viktime të dhunës në Kosovë dhe ata që e monitorojnë punën e Komisionit. Ai tha se është debatuar në disa mbledhje radhazi lidhur me moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe propozoi të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në rendin e ditës të seancës plenare të vihet si pikë shqyrtimi moszbatimi i vendimeve të KPMK - së. Arsyetimin për propozim që kjo çështje të vihet në rend të ditës e mbështeti në faktin se vazhdimisht kemi pasur ankesa të kësaj natyre për mos zbatimin e vendimeve të plotfuqishme.

Pasi që për këtë pikë nuk pati diskutime, Komisioni nxori këtë:

#### **P ë r f u n d i m**

Komisioni vendosi që t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës me propozimin që në seancën plenare të radhës të vihet në rend të ditës: Shqyrtimi i moszbatimeve të vendimeve të KPMK - së nga ana e organeve përkatëse.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje**

**Kryetari** - Tha se Projektligji në fjalë e ka kaluar leximin e parë nga ana e Kuvendit dhe se ka pasur shumë vërejtje nga disa deputetë. Sa i përket rëndësisë që e ka ky projektligji ishte i mendimit të organizohet një tryezë e rumbullakët dhe të ftohen grupet e interesit për ta dhënë kontributin e tyre. Prandaj duhet t'i përmbahen afatit të paraparë të rregullës 35. pika 2 të Rregullores së punës të Kuvendit.

**Ibrahim Makolli** - Tha se është një ligj i rëndësisë së veçantë dhe ka nevojë të bëhet një punë më intensive.

**Drita Maliqi** - Kërkoj sqarim nga përfaqësuesja e Agjencisë për Barazi Gjinore rreth implementimit të Rregullores së UNMIK - ut nr. 2003/12. Sa është zbatuar

në praktik? Ajo duke u ndërlidhur me Projektligjin dhe planin kombëtar tha se duhet të ekzistojë për identifikimin e problemeve në mënyrë që të jetë e mundshme parandalimi i dhunës në familje.

Për këtë pikë diskutuan Shqipe Krasniqi dhe Ibrahim Makolli.

Në bazë të rregullës 49, pika 1, të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, lidhur me caktimin e grupit të punës nxori këtë:

## **P e r f u n d i m**

### **Formohet Grupi i punës në këtë përbërje:**

1. Nerxhivane Dauti, kryetare,
2. Ibrahim Makolli, anëtar,
3. Drita Maliqi, anëtare dhe
4. Danush Ademi, anëtar.

Komisioni do të njoftohet nga grupi i punës me shkrim lidhur me përmbajtjen e amendamenteve në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, të cilat do t'i miratojë .

### **6. Të ndryshme**

Komisioni e shqyrtoi ankesën e Millorad Bullaiqit nga Prishtina, me banim të përkohshëm në Beograd, e cila ka të bëjë me një kontest prone. Komisioni, pasi e shqyrtoi ankesën, konstatoi se nuk bie në fushëveprimin e tij dhe vendosi që të njëjtën ankesë t'ia adresojë Agjencisë Kosovare të Pronave në Prishtinë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Kryetari i Komisionit

-----  
Ismet Beqiri